

# OUCH!

## NË KËTË NUMËR..

- Mbrojtja e tabletit tuaj
- Mbajtja e tabletit tuaj të sigurt

## Mbrojtja e tabletit tuaj të ri

### Përmbledhje

E gëzofsh tabletin tënd të ri. Kjo teknologji është e fuqishme dhe e mënyrë e përshtatshme për të komunikuar me të tjerë, për të bërë blerje online, për të parë filma, luajtur lojra dhe për të kryer shumë aktivitete tjera. Pasi tableti juaj me siguri do të bëhet një pjesë e rendësishme e jetës suaj, madje edhe mund ta zëvendësojë kompjuterin tuaj, gjëni më poshtë disa hapa që ju duhet të ndiqni që ta mbani të sigurt tabletin dhe informacionin që e ruani në të.

### Botuesi i ftuar

Lori Rosenberg ka përvijë të madhe në zhvillimin e materialeve trajnuese mbi sigurinë e informacionit, për punëtorë dhe klientë, si dhe është i apasionuar në gjetjen e menyrave të reja për të ndarë njohuritë e saj me të tjerët. Ju mund ta gjëni atë në Twitter si [@InfoSecLori](#).

### Mbrojtja e tabletit tuaj

Do të mund të çuditëni kur ta kuptoni se rreziku më i madh i tabletit tuaj nuk janë hakerët, por me siguri jeni ju. Ka shumë më shumë gjasa që ju ta humbisni, harroni, apo t'ju vidhet tableti juaj se sa të sulmohet nga hakerët. Gjëja e pare që duhet të bëni që të mbronit tabletin tuaj është ta aktivizoni mbylljen automatike të ekranit. Kjo nënkupton që sa herë që ju dëshironi ta përdorni tabletin tuaj duhet së pari ta çbllokoni ekranin me një fjalëkalim të fortë, një shenjë rrëshqitëse ose shenjat tuaja të gishtërinjëve. Kjo ju siguron që nëse e humbisni apo ju vidhet tableti juaj askush nuk mund t'i qaset atij, duke e mbrojtur kështu informacionin tuaj personal, aplikacionet tuaja mobile, dhe çdo gjë brenda. Pasi të keni aktivizuar mbylljen automatike të ekranit, më poshtë gjëni këshilla tjera që ju ndihmojnë juve ta mbronit tabletin tuaj:

1. Instaloni apo aktivizoni softuerin që ju ndihmon ta gjurmoni tabletin tuaj me anë të internetit. Në këtë mënyrë nëse tableti juaj vidhet apo ju humbet, ju mund të lidheni në Internet dhe ta gjëni vendndodhjen apo në rastin më të keq të mundshëm në distancë t'i fshini informatat nga tableti.
2. Përditësoni pajisjen tuaj dhe duke aktivizuar përditësimin automatik ashtu që të merret vazhdimisht versioni më i ri i sistemit operativ. Sulmuesit vazhdimisht kërkojnë mangësi në softuere dhe prodhuesit e softuerëve vazhdimisht lëshojnë në përdorim përditësime dhe rregullime për t'i mbyllur këto mangësi. Duke përdorur sistemin e fundit operativ dhe versionin e fundit të aplikacioneve mobile, ju e bëni më të vështirë për dikë që të futet pa leje në tabletin tuaj.
3. Kushtoni vëmendje gjatë konfigurimit të tabletit për herë të parë, sidomos në rregullimet e privatësisë. Një nga çështjet më të ndjeshme që lidhen me privatësinë është mundësia e tjerëve që të gjejnë dhe të dinë vendndodhjen tuaj. Ne

## Mbrojtja e tabletit tuaj të ri

ju rekomandojmë që ta çaktivizoni këtë funksion, dhe pastaj ta aktivizoni vetëm te aplikacionet që mendoni se ju duhen. Përdisa aplikacione është e rëndësishme që të dinë vendndodhjen tuaj, si për shembull softuerë hartash ose për të gjetur një restorant afër jush, por shumica e aplikacioneve nuk kanë nevojë për vendndodhjen tuaj.

- Shumica e tableteve dhe aplikacioneve i ruajnë të dhënat tuaja në Mjegull (ang. Cloud). Prandaj sigurohuni të kuptoni ku janë të dhënat tuaja dhe si mbrohen ato. Për shembull, gjëja e fundit që do donit të ndodhte është që fotografitë tuaja private të shpërndahen në Internet që të shihen nga e gjithë bota, bashkë me vendndodhjen gjeografike të vendosur ngjitur. Si fillim, çaktivizoni çfarëdo vendosje automatike të të gjithë përmbajtjes në Cloud, dhe pastaj ta aktivizoni vetëm kur doni të vendosni diçka specifike në Cloud.
- Tabletët gjithmonë e më shpesh sinkronizojnë aplikacionet tuaja me pajisje tjera si telefona të mençur ose laptop. Sinkronizimi është një funksion shumë i mirë por kujdes se çfarë aplikacione apo gjëra sinkronizoni. Nëse e keni të aktivizuar sinkronizimin, mos u habitni nëse e shihni që të gjitha faqet e internetit që keni vizituar në tablet të shfaqen edhe në shfletuesin e internetit në punë.



*Mënyra më e mirë që ta mbron tabletin tuaj është ta aktivizoni mbylljen automatike të ekranit, rregullimi i opsioneve të privatësisë, si dhe ta mbani të përditësuar tabletin tuaj.*

## Mbajtja e tabletit tuaj të sigurt

Pasi ta keni siguruar tabletin tuaj, ju duhet të mundoheni ta mbani të sigurt gjithmonë. Ja disa këshilla si ta mbani të sigurt tabletin tuaj për një kohë të gjatë.

- Kurrë mos e hiqni mbrojtjen (ang. Jailbreak) në tabletin tuaj. Kjo do të anashkalojë mbrojtjen dhe kontrolle të sigurisë dhe ta bëjë tabletin tuaj të çnueshëm ndaj sulmeve.
- Shkarkoni vetëm aplikacione të cilat ju duhen dhe nga burime të sigurta. Për iPads, shkarkoni aplikacione vetëm nga iTunes. Këto aplikacione janë kontrolluar para se të jenë në dispozicion. Për Google ne ju rekomandojmë që të shkarkoni aplikacione vetëm nga Google Play dhe për tabletë nga Amazoni ne ju rekomandojmë të merrni vetëm nga Amazon App Store. Përdërisa ju mund të shkarkoni nga faqe tjera, kjo nuk është e sigurt dhe mund të jenë të infektuar. Në fund, pa marrë parasysh se nga ku e keni marrë aplikacionin tuaj, kur nuk ju duhet më ose kur nuk e përdorni me rregull, ne ju rekomandojmë ta largoni nga tableti juaj.

## Mbrojtja e tabletit tuaj të ri

- Kur e instaloni një aplikacion të ri, sigurohuni që të shihni opsionet e privatësisë, njësoj sikur kur e konfiguruar tabletin tuaj në fillim. Kini kujdes se çka lejoni që të ketë qasje aplikacioni juaj. Për shembull a ka nevojë që një aplikacion që sapo shkarkuat të ketë qasje në të gjithë kontaktet tuaj? Nëse nuk ndiheni rehat që të ketë këto qasje nga aplikacioni, gjeni një aplikacion tjetër që plotëson kërkesat tuaja. Poashtu, kontrolloni qasjet në vazhdimësi për tu siguruar që nuk kanë ndërruar ndërkohë.

Tableti juaj është një pajisje e fuqishme, një pajisje që duam ta shijoni dhe ta përdorni. Duke i mbajtur mend këto hapa të thjeshtë ju mund të siguroheni që tableti juaj mbetet i sigurt.

## Mëso më shumë

Regjistrohuni në buletin tonë mujor për vetëdijësimin mbi sigurinë OUCH!, qasuni në arkivat e OUCH!, dhe mësoni më shumë mbi zgjidhjet për ngritjen e vetëdijes mbi sigurinë të ofruara nga SANS duke na vizituar në faqen

<http://www.securingthehuman.org>.

## Edicioni në shqip

Edicioni në shqip i OUCH! është përkthyer nga gjuha angleze nga Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano. Iliri është magjistër i shkencave në administrimin e rrjetave dhe sistemeve kompjuterike, është ligjërues në universitet për lëndë të ndryshme nga fusha e TI, dhe është përgjegjës për sigurinë e teknologjise informative në bankë. Jorida është përkthyes profesioniste e gjuhës angleze në OSBE.

## Burimet

Përdorimi i sigurt i aplikacioneve Mobile:	<a href="https://www.securingthehuman.org/ouch/2015#january2015">https://www.securingthehuman.org/ouch/2015#january2015</a>
Pasfrazat:	<a href="https://www.securingthehuman.org/ouch/2015#april2015">https://www.securingthehuman.org/ouch/2015#april2015</a>
Përdorimi i sigurt i Cloud:	<a href="https://www.securingthehuman.org/ouch/2014#september2014">https://www.securingthehuman.org/ouch/2014#september2014</a>
Shkatërimi i sigurt i pajisjes suaj mobile:	<a href="https://www.securingthehuman.org/ouch/2014#june2014">https://www.securingthehuman.org/ouch/2014#june2014</a>
SANS Security Tip of the Day:	<a href="https://www.sans.org/tip_of_the_day.php">https://www.sans.org/tip_of_the_day.php</a>

OUCH! botohet nga SANS Securing The Human dhe shpërndahet nën licencën [Creative Commons BY-NC-ND 4.0](https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/). Lejohet ta shpërndani këtë buletin ose ta përdorni për programet tuaja vetëdijësuese, për sa kohë nuk e modifikoni përmbajtjen e buletinit. Për përkthimet apo më shumë informata, ju lutemi na kontaktoni në [ouch@securingthehuman.org](mailto:ouch@securingthehuman.org).

Bordi editorial: Bill Wyman, Walt Scrivens, Phil Hoffman, Bob Rudis  
Përkthyer nga: Ilir Bytyçi dhe Jorida Nano



[securingthehuman.org/blog](http://securingthehuman.org/blog)



[/secrethehuman](https://www.facebook.com/secrethehuman)



[@secrethehuman](https://twitter.com/secrethehuman)



[securingthehuman.org/gpl](https://www.securingthehuman.org/gpl)